



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr 19/1 Prot

Tiranë, më 08.01.2026

NJOFTIM PËR AUDICION
KORI I ZËRAVE TË BARDHË

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, Statutit të miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, shpall audicionin për korin e “Zërave të Bardhë”, për fëmijët nga mosha 7-12 vjeç, i cili do të mbahet më 20.01.2026, ora 17:30 në Hollin e Katit të Dytë të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Fëmijët pjesëmarrës do të performojnë nëpërmjet një materiali si: këngë ose romancë të zgjedhur nga ata vetë dhe gjatë performancës do të testohen për veshin melodik, ritmik dhe për aftësitë e tyre vokale.

Për të dërguar të dhënat e fëmijës tuaj (certifikatën personale të fëmijës nga portali qeveritar e-albania, certifikata pjesëmarrjeje në aktivitete të ndryshme që lidhen me kanton apo me instrumentin muzikor që mund të luajnë, shkollën në të cilën studiojnë dhe një numër kontakti të kujdestarit ligjor) dhe për çdo paqartësi mund të na kontaktoni në e-mail-in zyrtar të TKOBAP-së: sekretaria@tkob.gov.al deri më 18.01.2026 dhe po nga e njëjta adresë do të merrni edhe konfirmimin e pjesëmarrjes ose jo të fëmijës në audicion.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aulon Naci

